

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA LIPJAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit: 613-20-4593-1-2-1

Sa i përket tenderit për: Blerja e aparaturave per QKMF-Lipjan

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Ntsh "AtomMed"

(Sheno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr: Uran Tinova p.n

(Adresa)

Ferizaj

70000

(Vendi)

(Kodi postar)

049530552

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Donika Prekadini

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

atommed@hotmail.com


(Adresa elektronike)

14.10.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit



Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Adresa elektronike)

(Numri i faks-it)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vulë)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriterin për dhënie të kontratës.

- Njoftimi për kontratë me dt. 10.09.2020 përmes prokurimit elektronik
- Kërkesa për sqarim të tenderit 23.09.2020
- Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 30.09.2020
- Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 09.10.2020
- Kërkesa për ri-shqyrtim dt. 06.10.2020

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po <input type="checkbox"/>		Jo <input type="checkbox"/>

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtejshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shitesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:*

Po <input type="checkbox"/>		Jo <input type="checkbox"/>
-----------------------------	--	-----------------------------

**6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Amulim.*

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 28 i LPP-së
Neni 53 i LPP-së
Neni 108/A i LPP-së
Neni 4.1 i RRUOPP
Neni 4.4 i RRUOPP
Neni 18.9 i RRUOPP
Neni 18.10 i RRUOPP-së
Neni 20 i RRUOPP



Neni 25 i RRUOPP

Neni 6 i Rregullat për parashtrimin e ankesave

Neni 8 i Rregullat për parashtrimin e ankesave

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Të nderuar, Ju njoftojmë se Komuna e Lipjanit dt.10.09.2020, për këtë aktivitet të prokurimit e ka publikuar Njoftimin për Kontratë në platformën elektronike, përmes *Procedurës së Hapur*.

Ne konform afateve të përcaktuara me dispozitat e prokurimit publik jemi munduar që përmes kërkesës për sqarime shtesë me dt. 23.09.2020, nga autoriteti kontraktues në këtë rast Komuna e Lipjanit, i kemi paraqitur 2 pika shqetësuese për ne, njëra ka qenë sa i përket pikës 7.2 të kërkesat e pershtatshmeris profesionale: "Licence nga AKPM si qarkullues me shumice per produkte dhe paisje Medicinale ( me Validitet)", si dhe rishikimit të specifikimeve teknike të cilat janë shumë fikse.

Në këtë rast Komuna e Lipjanit ka bërë shkelje të nenit 53 të LPP-së, dhe nenit 25 të RRUOPP-së, duke mos na ofruar qofshin ato informata plotësuese në mënyrë që ta përgatisim ofertën tonë, apo të na njoftoj për refuzimin e kërkesës. Me këtë mos veprim të tyre AK, bënë shkelje me radhë, të nenit 18.10 të RRUOPP-së, ngase aty citohet se ekzistojnë katër procese të cilat AK duhet t'i respektoj deri në praninë të tenderëve, dhe njëri ndër këto katër procese është "Procesi i ofrimit të sqarimeve dhe informatave shtesë në dosjen e tenderit".

Duke mos dhënë informacione shtesë, Komuna e Lipjanit, I bënë dy ndryshime të njëpasnjëshme duke publikuar formularin standard për korrigjimin e gabimeve B54, duke përmirësuar pikën 7.2 sa i përket Licencës nga AKPM, konform kërkesave tona. Por nuk i bënë ndryshimet e kërkuara në specifikime teknike. Por ashtu, bënë edhe veprime jo ligjore duke e përmirësuar Dosjen e Tenderit. Ndërsa kërkesat ligjore janë që ndryshimet në Dosje të Tenderit duhet të bëhen vetëm përmes formularit standard për korrigjime B54.

Andaj, pretendimi jonë ankimor është se, Komuna e Lipjanit ka përdorur specifikimet teknike që i janë pershtatur prodhuesëve të caktuar në Kosovë, duke na injoruar, diskriminuar dhe pamundësuar pjesëmarrjen tonë në këtë aktivitet të prokurimit por edhe OE tjerë.

Në momentin që i kemi shikuar specifikimet teknike për këto paisje të këtij aktiviteti të prokurimit, specifikime të cilat janë fikse, automatikisht nënkupton se janë specifikime të përshtatura, dmth nuk e kanë toleruar një minimum apo një maksimum të vlerave. Kur këto vlera nuk tolerohen, si masa, pesha apo dimensione, të ndryshme atëherë këto kërkesa paraqesin anën favorizuese dhe jo profesionale.

Përshkak të mos marrjes të ndonjë përgjigje nga ana e autoritetit kontraktues ne jemi detyruar që më dt. 06.10.2020, brenda afatit ligjor të parashtrijmë përmes Kërkesës për ri-shqyrtim pranë autoritetit kontraktues, pretendimet tona ankimore, duke kërkuar nga autoriteti kontraktues që të ndërmarrë veprimet ligjore të nevojshme dhe të eliminojë lëshimet apo shkeljet ligjore që janë në kundërshtim me dispozitat e Prokurimit Publik.

Ne kete aktivitet të prokurimit jane kerkuar disa paisje mjekësore, në këtë pozicione:

**1-Aparat Oksigjeni-** Kapaciteti 10 Litra (është fiks, kërkesa jonë është që të jetë variabil dhe ta ketë një minimum dhe maksimum të lejuar)

**3-Aspirator Kirurgjik Portable-** Pësja 4 kg dhe me dimensione 40.5cm-20cm-36cm (të lejohet mundësia e ofertimit me pësja të përafërta dhe me dimensione variabile, sepse nuk është kërkesë profesionale).

**4-Numruer Hematologjik Digjital-** vëllimi 50l. (kërkesa jonë është që të jetë variabil dhe ta ketë një minimum dhe maksimum të lejuar).

**5-Centrifug Laboratorike-** Parametrat janë të vendosur në mënyrë fikse dhe vëllimi i mostrës në 25 ul (kërkesa jonë të gjeneralizohen parametrat dhe vëllimi të jetë variabil dhe ta ketë një minimum dhe maksimum të lejuar).

**6-Centrifug Laboratorike –** Numri i vendeve të përcaktuara sakt 25 vende (kërkesa jonë është që të jetë variabil dhe ta ketë një minimum dhe maksimum të lejuar).

Andaj, kërkesa jonë ka qenë dhe është që përshkrimi i specifikimeve teknike të mos bëhet në këtë mënyrë, ato të jenë më variabile mos të jenë fikse, të hapet tregu dhe mos të bëhen diskriminime.

Sepse me dispozitat e prokurimit publik përshtatja e specifikimeve është në kundërshtim me nenin 28 paragrafi 2 të LPP-së ku shkruan "Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Kjo formë e veprimit lenë të kuptohet se Njësia e Kërkesës ose nuk ka staf të kualifikuar për hartimin e specifikave të këtyre paisjeve ose me qëllim ju kanë ofruar nga OE i favorizuar. Sepse këtu dihet qartë se nuk janë përfill dispozitat e prokurimit publik.



Autoriteti kontraktues lidhur me kërkesën tonë për rishqyrtim nuk e bënë pezullimin e procedurës së këtij aktiviteti dhe nuk nuk merrë asnjë vendim lidhur me aprovimin apo refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim, duke mos i mjaftuar shkeljet e sipër përmendura dhe duke mos e marrë për bazë as kërkesën për ri-shqyrtim, bënë shkelje të nenit 108/A të LPP-së, dhe dispozitave të Rregullave për parashtrim të ankesave, konkretisht nenit 6 dhe 8. Duke mos shqyrtuar kërkesën tonë si dhe duke mos lëshuar ndonjë vendim konform këtyre dispozitave që janë të detyrueshme për autoritetin kontraktues dhe duhet të zbatohen menjëherë.

Në shprehim shqetësimin tonë lidhur me këtë, pasi që kjo është bërë e qëllimshme, duke bllokuar tregun, eliminuar konkurrencën dhe pamundësinë e ardhjes së një oferte më të mirë dhe më të favorshme. Ku të gjitha aktet legjislative primare dhe sekondare të Prokurimit Publik, e ndalojnë përgatitjen e Dosjes së Tenderit që në një mënyrë favorizon ose diskriminon kundër një ose më shumë Operatorëve Ekonomik potencial. Kjo është e cekur edhe në Nenin 7 të LPP-së, Është parimi bazë i Prokurimit Publik, ku cekë se Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Madje edhe parim i direktivave të BE-se, është se: "Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik."

Po ashtu edhe me nenin 4.4 të RRUOPP e obligon që Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprojë në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për furnizuesit ose furnizuesit potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

Gjithashtu neni 18.9 i RRUOPP-së përcakton qartë "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

- Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
- Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.

Lidhur me të gjitha këto parregullësi, Komuna e Lipjanit, përveç shkeljeve të lartëpërmendurs, në mënyrë direkte ka bërë edhe shkelje tjera të këtyre dispozitave të prokurimit publik, e të cilat janë:

**Neni 1 i LPP-së**, e obligon që të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6 i LPP-së, e obligon që të siguron që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Dhe jo të veprohet edhe më tutje me këto kërkesa dhe në këtë mënyrë, ku ju, si autoritet kontraktues rrezikoni seriozisht të dëmtoni buxhetin sepse në momentin kur kufizohet konkurrenca për OE të caktuar, atëherë mundësia është shumë e madhe që të ofrohen çmime shumë më të larta, se sa vlera e tregut, prandaj edhe rrezikohet të arrihet qëllimi i LPP-së.

Neni 4.1 i RRUOPP-së, citon "AK gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit janë të obliguar të marrin masa të nevojshme për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim në mesin e Operatorëve Ekonomik.

Duke pasur parasysh argumentet dhe faktet e lartcekura, kërkojmë nga OSHP që të marrë:

#### VENDIM

**APROVOHET:** Ankesa e OE Ntsh "AtomMed" si e bazuar

**ANULOHET:** ky aktivitet i prokurimit apo të ndryshohen specifikimet teknike duke i bërë më variabile dhe të jenë konform dispozitave të LPP-së dhe të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

#### 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:*

Neve si Operator ekonomik na janë bërë dëme materiale dhe jomateriale. Për përgatitjen rreth këtij aktiviteti, shpenzime të letrës, stafit, si dhe shpenzime në përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës, diku në vlerë rreth 2,000.00 €.

#### 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitnikërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.